REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 30/17, 34/17
Datë/Datum. 20.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komuna Kaçanik"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 30 -34/17.**
Nga:	Sofije Saramati - Eksperte shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me material harxhues-administrativ për shck-ën, shkollat zjarrifikësit dhe shëndetësinë"**, me nr. të Prokurimit: KA-652-16- 109-121		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE- N.T.P "VLORA" – Prishtinë, dhe OE, "INFINIT" SH.P.K- Prishtinë**		
Datë			**20.02.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: **OE- N.T.P "VLORA" – Prishtinë, dhe OE, "INFINIT" SH.P.K- Prishtinë,** kundër AK – **"Komuna Kaçanik"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me material harxhues-administrativ për shck-ën, shkollat, zjarrifikësit dhe shëndetësinë"** me nr. të Prokurimit: **KA-652-16- 109-121.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		06.02.2017		10.02.2017		20.02.2016
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **27.01.2017**, OSHP, ka pranuar ankesën me nr. **30/17,** e parashtruar nga OE: **N.T.P "VLORA" – nga Prishtinë**, si dhe me daten **02.02.2017**, OSHP, ka pranuar ankesen me nr **34/17**, nga OE **"INFINIT" SH.P.K- nga Prishtinë**, kundër AK – Komuna Kaçanik, lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Furnizim me material harxhues-administrativ për shck-ën, shkollat, zjarrifikësit dhe shëndetësinë"**-me nr. të Prokurimit: **KA-652-16- 109-121.**

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Kaçanik.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues N.T.P "VLORA" – Prishtinë, dhe OE **"INFINIT" SH.P.K- Prishtinë.**

Pikat e Ankesës nga OE **N.T.P "VLORA" – Prishtinë.**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-diskriminimi

Neni 10 paragrafi 7 - Mjetet per promovimin e transparencës

Neni 59 paragrafi 4 - Ekzaminimu, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 61 paragrafi 1,2,3,4 - Tenderët jo-normalisht të ulët

Neni 65 - Pranushmëria e kandidatëve ose tenderuesve

Neni 66 – Përshtatshmëria profesionale

Neni 69 - Aftësitë teknike dhe profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Komisioni vlersues nuk ka vlersuar drejtë aktivitetin e prokurimit, prandaj dhënia e kësaj kontrate bie ndesh me LPP dhe rrezikon të demton buxhetin e shtetit përkatësisht KK Kaçanik. Gjatë procesit të qasjes në dokumentacionin tenderik të operatorëve pjesmarrës në këtë procedurë ne kemi vërejtur se

disa operator janë të papërgjegjshëm dhe me anë të kësaj kërkese për ri-shqyrtim kërkojmë nga AK që njoftimin për dhënie të kontratës ta anuloj dhe ta kthejë lëndën në ri-vlersim.

OE Rilindja: Nuk i ka përshkruar të dhënat obligative në formularin C (Emrin e AK, Titullin e tenderit, numrin e prokurimit nuk e ka përshkruar % e sigurimit të ekzekutimit në rast se fiton kontratën si dhe e ka gabuar validitetin e tenderit i cili në DT dhe njoftimin për kontratë është 60 ditë ndërsa ky operator ka përshkruar validitetin 90 ditë).

OE Rilindja poashtu nuk ka përshkruar enrin e kompanisë te deklarata nën betim:

(Operatori ekonomik që paraqiteti).

OE rilindja në dosjen e tenderit nuk ka përshkruar emrin e kompanis Cerifikatën e TVSH--së, kërkesë në

FDT, pika 7.1 dhe 7.2.

Po ashtu në ofertën OE Rilindia kemi vërejtur çmime manipulative, jo normalisht të Ulta.

Në bazë të nenit 61 paragrafit 1 Autoriteti kontraktues obligohet që operatorit ekoronik ti dergojë letër Standarde për çnime jo normalisht të ulëta dhe të meren parasysh shpjegimet e dërguara nga OE sipas paragrafit 2. Po i përmendim në vijim disa prej pozicioneve ku kemi vërejtur cmime deri në 5O herë më të ulta se cmimet reale të tregut.

3,4,5,6,37,38,42,43,44,94, 109, 117, 118, 121,128,129, 37,38,144, 145,147,148,149, 150.452,153,154. 155,156,157,158,159,160,161,163,165,166,168,171,174,178,181, 182, 184, 186

dhe bazuar në këto AK është dashur që konform Nenit 61, paragrafit 4 ta refuzoj Ofertën e OE Rilindja. Poashtu operatori i shapllur fitues nga AK nuk i ka në dosje bashkangjitur vërtetimin e ATK-së dhe vërtetimin nga organi komunai sipas kërkesës në FDT Neni 6.4 të cilat është dashur të kërkohet para se të shpallet fitues dhe të dërgohet njoftimi per dhenie në KRPP. O H. PromiX: Nuk i ka përshkruar të dhënat obligative në formularin C (Emrin e AK, Titullin e tenderit, numrin e prokurimit, nuk e ka përshkruar % e sigurimit të ekzekutimit në rast se fiton kontratën) Nuk ka plotësuar identifikimin financiar. Lista e kontratave e këtij OE është e mangët, nuk është plotësur sipas kërkesës në FDT- Neni 9.1, numrin e prokurimit dhe datat e kontraktimit nuk i përmban lista. Poashtu OE është dashur të eliminohet pasiqë nuk ka ofruar dëshmi, kontrata dhe referenca me tonera por vetëm me material zyrtar. Në bazë të Nenit 61 paragrafit 1 Autoriteti kontraktues obligohet që operatorit ekonomik ti dergojë letër standarde për çmime jo normalisht të ulëta dhe të meren parasysh

S.S

shpjegimet e dërguara nga OE sipas paragrafit 2. Po i përmendim në vijim disa prej pozicioneve ku kemi vërejtur Cmime deri në 100herë më të ulta se cmimet reale të tregut.

3,4,5,6,7,8,9,10,12,28,29,37,38,40,4142,43,47,66, 75,8492.96,101,102,103,106,108,109,112,118,119, 120,121,126,127,128,129, 130,136,137,138,139,140,141,142, 143,144, 145,146,147,148,149,150,151, 152,153,154,155,156,157,158,159,160,162, 163,164,165,166,167,168,169,170,171,172,173,174, 175,176, 178,179,180,181,182, 183,184, 185, 186,187,188, 189,190,191.

dhe bazuar në këto AK është dashur që konform Nenit 61, paragrafit 4 ta refuzoj Oferten e OE Promix.

OE Stargraf: Oferta e këtij operatori është thuajse 95% identike me ofertën e OE Promix, renditja e dokumentacionit tenderues është e njejtë, nr serik të policës së sigurimit janë me

radhë 75180, 75181 vërehet se dy ofertat janë të plotësuara nga një dorë dhe një

kimik i njejtë, cmimet në ofertë janë identike, nga 191 artikuj sa ka në DT 183 çmime janë identike në dy ofertat. Përderisa dy ofertat janë plotësuar nga një person mangësitë në dokumentacion janë të njejta si të OE Promix dhe Stargrafi

Nuk I ka përshkruar të dhënat obligative në formularin C (Emrin e AK, Titullin e tenderit, numrin e prokurimit, nuk e ka përshkruar % e sigurimit të ekzekutimit në rast se fiton kontratën).

Nuk ka plotësuar identifikirnin financiar.

Lista e Kontratave e këtij OE është e mangët, nuk është plotësur sipas kërkesës në FD"- Neri 9.1, Turnrin e prokurirni dhe datat e kontraktimit nuk i përmban lista. Poashtu OE është dashur të efinirohet pasiqë nuk ka ofruar dëshmi, kontrata dhe referenca retorera por vetëm me materia zyrtar. i Në bazë të Nenit. 61 paragrafit " Autoriteti kontraktues obligohet që operatorit ekonorik i dergojë letër standarde për çmime jo normalisht të ulëta dhe të meren parasysh shpjegimet e dërguara nga OE sipas paragrafit 2. Po i përmendim në vijim cisa prej pozicioneve ku kemi vërejtur cmime deri në 100 herë më të ulta se cniret reale të tregut: 3,4,5,6,7,8,9, O, 12,28,29,37,38,40,442,43,47,66, 75,84.92, 96,101,102,103,106, 1081C9,12148′ 49,120121,126127128129.130.136138,139.440.141,142,144, 145,146, 47,148,49,15C, 151,152,153,154,155,156,157,158,159,160,162,163,164, 165,166.67, 168,169,170, 71,172,173,174,175,176, 178,179,180,181,182, 183,184, 185,186,187,188, 189,190,191. dhe bazuar në këto AK është dashur që konform Nenit 61, paragrafit 4 ta refuzoj ofertën e OE Stargraf. Përveq të dhënave të lartëcekura OE kanë edhe gabime tjera teknike në DT por të cilat nuk

S.S

qojnë shumë peshë dhe nuk do ti përmendim.

Vërejtje: AK KK Kaçanik përveq shkeljeve të lartëcekura gjatë zhvillimit të procedurës së vlersimit ka shkelur LPP edhe me rastin e zhvillimit të qasjes sonë në ofertat e operatorëve tjerë, në bazë të LPP ne kemi kërkuar nga një kopje të ofertave/listat e çmimeve të operatorëve tjerë pjesmarrës dhe na është caktuar tarifë 2 euro për faqe nga personi pergjegjës në zyrën e prokurimit.

Ndërsa neni 18.8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për PP përcakton: 18. 8 "AK gjithnjë do të vë dosjen e tenderit në dispozicion përmes Sistemit të prokurimit elektronik, pa pagesë për çdo OE. AK mund të kërkojë një pagesë në rast kur Çmimi i prodhimit të materialit tenderues konsiderohet i shtrenjtë p.sh. modelet e printuara ose numër i lartë i printimeve teknike të cilat nuk janë të përshtatshme për ti dërguar në formë elektronike përmes Sistemit të prokurimit elektronik. Shuma e pagesës e kërkuar me këto raste nuk mund te tejkaloje shumen e shpenzimeve për prodhim te materialeve" Në këtë rast shuma 34euro për 17fletë kopje është shumë e lartë, bashkangjitur gjeni edhe | interpretimin nga KRPP.

Demi Material

Dhënia e kontratës për OE i cili nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e ërzgjedhjes të përshkruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit ësht bër shkelje ligjore, na diskriminon neve si OE të përgjegjshëm dhe na mohon i një fitim simbolik të paramenduar nga kjo kontratë. | Me anë të kësaj ankese kërkojmë nga organi shqyrtues i prokurimit që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar, të detyroj AK KK Kaçanik që ta anulojë vendimin për dhënien e kontratës dhe lëndën ta kthejë në ri-vlersim, gjatë ri-vlersimit shpresoj të meren parasysh kërkesat tona, të ri-shikohen shkeljet e dispozitave ligjore të lartëcekura dhe të vlersohet drejtë tenderi konform ligjeve aktuale në fuqi Lgji Nr. : 04/L-237, Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/L-092.

S.S

Pikat e Ankesës nga OE "INFINIT" SH.P.K- Prishtinë.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-diskriminimi

Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 59 - Ekzaminimu, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 61 - Tenderët jo-normalisht të ulët

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Zyra e prokurimit pranë KK Kaçanik me 18.01.2017 na ka derguar letren Standarde per eliminim me arsyetim se nuk kemi paraqitur në dosjen e tenderit Certifikaten e TVSH-së dhe deklaratat e anetareve te konzorciumit veq e veq. Ne mendojmë se në këtë rast është vepruar në kundershtim me ligjin e ri per prokurim publik pasiqë zyra e prokurimit ka qene e obliguar qe dokumentet te cilat kan munguar ne oferten tone te na kerkoje gjate vlersimit dhe te na jepet nje afat i caktuar kohor per ti derguar gjithmone duke u thirur ne Nenin 72, pika 1,2,3.

Bazuar ne këtë me kërkojmë që të anulohet vendimi per dhenien e kontrates dhe te behet rivlersimi i aktivitetit te prokurimit konform ligjit te ri per prokurim publik.

Demi Material

Eliminimi i kompanisë sonë nga ky tender per mungese dokumentacioni demton imazhin tone njekohesisht na privon nga fitimi eventual i pritur nga kjo kontratë, andaj kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit që të aprovoj kerkesen tone dhe te detyroj KK Kacanik që ta kthej tenderin ne rivlersim.

S.S

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 05.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,.....26.08.2016
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes, ... 26.08.2016
Data e njoftimit per dhenje te kontrtes.....15.11.2016

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Euro Printi" shpk	Prishtinë	39.834.40	JO
2.	"Ofice Printi"	Prishtinë	39.777.73	JO
3.	NTP "Vlora"	Prishtinë	41.645.00	JO
4.	"Infiniti" shpk	Prishtinë	37.843.25	JO
5.	"Promix"	Ferizaj	36.218.10	JO
6.	"Libraria Rilindja"	Ferizaj	34.364.00	JO
7.	"Star Graf"	Ferizaj	37.317.00	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 25.10.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katërmbëdhjetë (8) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit –Azem Raka
- - Anëtar i komisionit - Rrahman Ceka
- - Anëtar i komisionit – Nuhi Krivanjeva

Data e mbarimit të vlerësimit: 04.01.2017
Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....05.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresues propozon dhenjen e kontrates kompanise : RILINDA SHPK, i pergjegjeshem dhe me çmimin me t e ulet.

5,5

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Infinit" eshte eliminuar me arsyetimin se: nuk ka ofruar certifikaten e TVSH-se.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne oferten origjinale të këti OE nuk gjendet a certifikaten e TVSH-se.Prandaj vlerëson AK-ja, gjate vlerësimit eshte dashur te respektoj nenin 72.Paragrafi 1,2,3, te LPP-se, Për te kërkuar sqarime shtes gjithë ashtu nën nenin 39.8 tërregullave dhe udhëzuesit operativ per prokurimin publik sqarohet se nese mungon mungon deklarata e TVSH-se mund te kërkohet sqarime Ky pretendim i OE ankues ësht i qendruesheëm prandaj edhe ekspertja shqyrtuese vlerëson se ankesa është e bazuar dhe duhet te obligohet AK- jan të veprojë në harmonin me nenin 72 LPP-së dhe nenin 39.8 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Sqarimi 2.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Vlora", ne ankesen e parashtruar i ka sulmuar disa operator ekonomik, ne vazhdimekspertja shqyrtuese, jep keto sqarime:

Ne lidhje me pretenidmet ankimore te te OE ankues "Vlora", lidhur me oferten e OE "Rilindja", sqaron se pretendimi ne lidhje me formularin C te tenderit eshte i paqnerueshem sepse OE Rilindja i ka plotësuar te dhenat e nevojshme dhe se pretendimi se ka ofruar 90 dite validitet ndersa AK-ja, ka kërkuar vetem 60 nuk perben shkelje. Poahtu sa i perket pretendimit se OE Rilindja nuk e ka shenuar emrin e kompanise ne deklaraten nen betim, eshte i paqenrueshem sepse OE ne deklaraten e tij i ka ofruar te gjitha te dhenat.

Ne lidhje me pretendimin ankimore se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka dorezuar vërtetimin e TVSH dhe njëherit pretendon se nuk AK-ja, nuk e ka kërkuar vërtetimin e ATK-se, ekspertja shqyrtues, sqaron se asnjeri nga dokumentet e kërkuara OE i rekomanduar nuk i ka dorezuar ne ofert dhe njëherit ekspertja shqyrtuese sqaron se AK-ja, para dheniees se kontrates eshte dashur ta kërkoj vërtetimin e ATK-se. Ne rastin konkret AK-ja, ka bere diskrimin gjate vlerësimit per faktin se pikërisht per certifikaten e TVHS-se e ka eliminuar OE "Infinit".

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Vlora", se OE "Rilindja", ka ofruar cmime manipulative, ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas nenit 61 te LPP-se, eshte e drejt e AK-se, vlerësimi i cmimeve.

Sqarimi 3

Ekspertja shqyrtues, sqaron se OE Vlora, ne ankes ka pretendime ankimore edhe ne oferten e OE Promix, per te cilin pretendon se nuk e kap lotesuar formularin C te dosjes se tenderit sipas OE vlora ky OE duhet te shpallet i papergjegjshem me sepse nuk ek a plotësuar sigurin e ekzekutimit, numrin e prokurimit. Ekspertja shqyrtuese sqaron se formulari i tenderit i ka te gjitha te dhenat e nevojshme

S. S

prandaj, ky pretendim eshte i paqendrueshem.
Sai parkete pretendimit te OE ankues se lista e kontratave nuk i permban te dhenat e nevojshme ekspertja shqyrtuese sqaron se ne ofert OE Promix, e ka dorëzuar listen e kontratave, kontatat dhe referencat. Prandaj ky pretenim eshte i paqendrueshem.
Poashtu sa i perket pretendimit ne lidhje me çmimin e ofruar nga OE Promix, ku OE ankues pretendon se OE Promix ka ofruar cmime Jo Normalisht te uleta, ekspertja shqyrtuese sic ka sqaruar edhe me lart vlerësimi i çmimit jo normalisht ulet eshte e drejt e autoritetit kontraktues.

Sqarimi 4

Ekspertja shqyrtuese , sqaron se OE ankues Vlora në vazhdim te ankesës te pretendon se oferta e OE Stargraf dhe OE Promix, jane te njëjta sepse e kan numrin e sigurimit te ofertes 75180 perkatesisht 75181,ekspertja shqyrtuese sqaron se ky argument është si element per tu kualifikuarë si i papergjegjshem ,mirpo ne rast te dyshimeve ,komform nenit 130 të LPP-se PSH-ja mund të nrejtohenë në MPB.
Poashtu OE ankuesi Pretendion se Formulari C i OE Stargraf nuk është potesuar dhe se ky OE duhet te shpallet i papergjegjshem, ekspertja shqyrtuese sqaron se ne fermulen C ësht i plotësuarë dhe se i permianë te dhënat. Poashtu se i perket pretendimit ne lidhje me çmimin jo normalishtet ulet sic ësht sqaruar edhe me lart kjo është e drejt e AK-se, per vlerësim te çmimit.

Sqarimi 5

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet te ri-vleresohet duke u bazuar ne konstatimet e mesiperme sepse sic eshte cekur edhe me lart AK-ja, e ka eliminuar per certifikat te TVSH-se OE Infinit, ndersa OE Rilindja e rekomandon pikërisht per kete certifikat, dhe njëherit AK-ja nuk ek a kërkuar para dhënies vërtetimin e ATK-se nga fituesi - Rilindja.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendojn që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Kaqanik**, për aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me material harxhues-administrativ për shck-ën, shkollat zjarrifikësit dhe shëndetësinë"**, me nr. të Prokurimit: KA-652-16- 109-121, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anuloj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënje të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERESIM**. ndërsa ankesat e OE-ve ankues te aprovohen si pjeserisht te bazuara.

SS